

Vendim nr. 75 datë 12.04.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Fiona Papajorgji,	Anëtare
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 12.04.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 2 (I) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **ILIR (ALBERT) KUPA**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 71, datë 19.05.2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë; nr. 92, datë 16.09.2016 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda; nr. 00-2022-1369 (289), datë 03.11.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: Nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “t”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Holta Zaçaj, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Mbi bazën e kërkesave të ardhura me letërporosi nga autoritetet gjyqësore greke, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë ka regjistruar procedimin penal nr. 294/1 në ngarkim të të pandehurit Ilir (Albert) Kupa (*kërkuesi*). Regjistrimi i procedimit penal ndaj kërkuesit lidhet me vendimin për t’i hapur rrugë

ekzekutimit të letërporosisë nga Ministria e Drejtësisë ardhur nga autoritetet gjyqësore greke. Konkretisht, prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Larisa në Greqi, me anë të një letërporosisë bazuar në konventën *“Për ndihmën e ndërsjellë juridike në fushën penale”*, u ka kërkuar autoriteteve gjyqësore shqiptare regjistrimin dhe ndjekjen penale të kërkuesit, si një ndër personat e burgosur dhe të arratisur në datën 22.03.2013 nga burgu Trikala-s, Greqi, ku ai po vuante dënimin. Kërkesa për ndjekje penale, e paraqitur nga autoritetet greke për kërkuesin, lidhej me disa vepra penale që sipas legjislacionit penal grek ishin: *nxitje për vrasje me paramendim, e mbetur në tentativë, e kryer në bashkëpunim në vazhdimësi në dëm të të gjithë punonjësve të burgut në Trikala Greqi; revoltë të burgosurish; nxitje për armëmbajtje të cilësuar armë luftarake dhe granatash në bashkëpunim; krijim bande të armatosur; mbajtje arme në burg për përdorim arme në lidhje me një krim tjetër*. Ministria e Drejtësisë, me shkresën nr. 1975/1 prot., datë 18.07.2014, i është drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme për vazhdimin e mëtejshëm të procedurave gjyqësore.

2. Në datën 14.10.2015 prokuroria ka paraqitur kërkesën për dërgimin në gjyq të çështjes penale në ngarkim të kërkuesit *për veprat penale “Grup i strukturuar kriminal”*, i parashikuar nga neni 333/a i Kodit Penal (KP), *“Kryerjen e veprave penale nga grupi i strukturuar kriminal”*, për veprat penale të kryera në kuadrin e grupit të strukturuar penal: *“Vrasje e punonjësve të policisë”*, kryer në bashkëpunim dhe e mbetur në tentativë, e parashikuar nga neni 79/b i KP-së, *“Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve dhe municioneve luftarake”*, e parashikuar nga neni 278/5 i KP-së, *“Largimi i të burgosurit nga vendqëndrimi”*, e parashikuar nga neni 323/2 i KP-së.

3. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me vendimin nr. 71, datë 19.05.2016, ka vendosur: *“Deklarimin fajtor të të pandehurit Ilir (Albert) Kupa për kryerjen e veprës penale “Grupi i strukturuar kriminal”, në formën e pjesëmarrjes parashikuar nga neni 333/a/2 i KP-së dhe dënimin e tij me 4 (katër) vjet burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit Ilir (Albert) Kupa për kryerjen e veprës penale “Vrasje në rrethana të tjera cilësuese”, ndaj punonjësit të policisë së Burgut të Mbyllur Trikala-Greqi, K.K, mbetur në tentativë, kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga neni 79/c i KP-së (i pandryshuar me ligjin nr. 144/2013) në lidhje me nenin 22, 28/4 dhe nenin 334/2 të KP-së dhe dënimin e tij me burgim të përjetshëm. Deklarimin fajtor të të pandehurit Ilir (Albert) Kupa për kryerjen e veprës penale “Vrasje në rrethana të tjera cilësuese”, ndaj punonjësit të policisë së Burgut të Mbyllur Trikala-Greqi, M. D, mbetur në tentativë, kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga neni 79/c i KP-së (i pandryshuar me ligjin nr.144/2013) në lidhje me nenin 22, 28/4 dhe nenin 334/2 të KP-së dhe dënimin e tij me burgim të përjetshëm. Deklarimin fajtor të të*

pandehurit Ilir (Albert) Kupa për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe municionit”, kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga neni 278/2 i KP-së (i pandryshuar me ligjet nr. 144/2013 dhe 98/2014) në lidhje me nenin 334/1 të KP-së dhe dënimin e tij me 7 (shtatë) vjet burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit Ilir (Albert) Kupa, për kryerjen e veprës penale “Largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit”, kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga neni 323/2 në lidhje me nenin 334/1 të KP-së dhe dënimin e tij me 12 (dymbëdhjetë) vjet burgim. Në zbatim të nenit 55 të KP-së, në caktimin e një dënimi të vetëm, i pandehuri Ilir (Albert) Kupa dënohet përfundimisht me burgim të përjetshëm. Në zbatim të nenit 406 të KPP-së, të pandryshuar me ligjin nr. 145/2013, i pandehurit Ilir (Albert) Kupa dënohet përfundimisht me 25 (njëzet e pesë) vjet burgim. Vuajtja e dënimit fillon nga dita e caktimit të masës së sigurimit “arrest në burg” për llogari të këtij procedimi penal më datë 14.06.2015 dhe do të kryhet në një burg të sigurisë së lartë...”. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi.

4. Me vendimin nr. 92, datë 16.09.2016, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr. 71, datë 19.05.2016 të Gjykatës për Krime të Rënda për sa i përket fajësisë dhe cilësimit ligjor të veprave penale në ngarkim të të pandehurit Kupa. Ndryshimin e këtij vendimi si më poshtë: Dënimin e të pandehurit Ilir (Albert) Kupa për kryerjen e veprës penale të “Vrasjes në rrethana cilësuese” ndaj punonjësit të policisë K.K., mbetur në tentativë, të kryer në bashkëpunim, në formën e “Grupit të strukturuar kriminal”, të parashikuar nga nenet 79/c (i pandryshuar me ligjin nr. (144/2013) 22, 28/4, 334/2 të KP-së, me 25 (njëzet e pesë) vjet burgim. Dënimin e të pandehurit Ilir (Albert) Kupa për kryerjen e veprës penale të “Vrasjes në rrethana cilësuese” ndaj punonjësit të policisë M.D, mbetur në tentativë, kryer në bashkëpunim, në formën e “Grupit të strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 79/c (i pandryshuar me ligjin nr. (144/2013) 22, 28/4, 334/2 të KP-së, me 25 (njëzet e pesë) vjet burgim. Lënien në fuqi të vendimit nr. 71, datë 19.05.2016 për pikat 1, 4, 5 të tij. Në zbatim të nenit 55 të KP-së, në bashkim të dënimeve, i pandehuri Ilir (Albert) Kupa dënohet me një dënim të vetëm prej 25 (njëzet e pesë) vjet burgim. Në aplikim të nenit 406 të KPP-së, i pandehuri Ilir (Albert) Kupa dënohet me 16 (gjashtëmbëdhjetë) vjet e 8 (tetë) muaj burgim. Lënien në fuqi të këtij vendimi edhe për pjesët e tjera të tij.”. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur rekurs Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, si dhe kërkuesi.

5. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-1396 (289), datë 03.11.2022, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 92, datë 16.09.2016 të Gjykatës së Apelit për

Krime të Rënda dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 71, datë 19.05.2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

6. Në datën 02.02.2023 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual për shfuqizimin e vendimeve objekt kërkese.

II

Pretendimet e kërkuesit

7. **Kërkuesi**, ka pretenduar, në mënyrë të përmbledhur, se gjatë procesit penal të kundërshtuar është cenuar:

- 7.1. *E drejta e aksesit dhe ajo për t'u dëgjuar*, pasi Gjykata e Lartë ka rënduar pozitën procedurale të kërkuesit duke e shqyrtuar çështjen në dhomë këshillimi, pa i dhënë mundësinë për t'u dëgjuar në seancë, si dhe duke i shtuar masën e dënimit edhe me 8 vjet, në tejkalim të kompetencave të saj.
- 7.2. *Parimi i prezumimit të pafajësisë*, pasi në asnjë nga shkallët e gjykimit nuk është provuar fajësia e kërkuesit. Gjykatat kanë shkelur nenin 390 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), duke e dënuar kërkuesin pa asnjë lloj prove dhe në kundërshtim të plotë me rrethanat e ngjarjes. Ato nuk kanë asnjë provë që ta implikojë atë në veprat e kryera nga grupi i strukturuar kriminal. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe Gjykata e Lartë kanë gabuar në zbatimin e nenit 55 të KP-së, sepse i kanë dhënë dënim më të madh sesa shuma aritmetike e të gjitha dënimeve për secilën vepër. Gjykatat e kanë rënduar artificialisht masën e dënimit, edhe pse pasojat nuk janë të rënda. Gjykata e Lartë i ka mohuar të drejtën e përfitimit nga ligji penal favorizues, si dhe ka shkelur nenin 48 të KP-së, pasi vendimi i shkallës së parë është dhënë në vitin 2016, përgjatë të cilit kërkuesi ka treguar respekt ndaj ligjit dhe ndaj bashkëvuajtësve, duke u zhveshur nga qenia “person me rrezikshmëri”.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i” dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit

publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Këto kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, pra mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyqimit kushtetues.

9. Kolegji, në verifikim të plotësimit të këtyre kriterëve, në rastin konkret vëren se kërkuuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe si bartës i të drejtave të pretenduara të cenuara ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

10. Në lidhje me shterimin e mjeteve juridike, sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit 8577/2000, Gjykata kryen gjykimin përfundimtar të ankesave individuale, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara në Kushtetutë, që individi pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Po kështu, neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000 përcakton se mjetet juridike efektive duhet të shterohen nga kërkuuesi përpara se ai t’i drejtohet Gjykatës.

11. Kriteri për shterimin e mjeteve juridike nënkupton se kërkuuesi duhet të shfrytëzojë paraprakisht në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete (*shih vendimet nr. 33, datë 01.11.2021; nr.17, datë 16.05.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Shterimi i mjeteve juridike ka të bëjë me kontrollin subsidiar që ushtron Gjykata, përfshirë edhe rastet e shkeljes së të drejtave të individit (*shih vendimin nr. 56, datë 25.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Duke qenë se mbrojtja kushtetuese ka një funksion subsidiar, kjo do të thotë se mund të kërkohej vetëm për një vendim gjyqësor përfundimtar që përmbyll procesin gjyqësor (*shih vendimet nr. 14, datë 11.03.2021, nr. 48, datë 06.07.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë gjatë gjyqimit në gjykatat e faktit, rezulton se kërkuuesi e ka ngritur atë në ankimin drejtuar gjykatës së apelit dhe në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë, kurse për sa i përket pretendimit për cenimin e së drejtës për proces të rregullt në Gjykatën e Lartë, kërkuuesi nuk ka mjetet tjera juridike në dispozicion përveç ankimit kushtetues individual. Për rrjedhojë ai ka shteruar mjetet e ankimit në dispozicion.

13. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi vendimi më i fundit që ka përmbyllur procesin gjyqësor të zhvilluar ndaj tij, ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, është i datës 03.11.2022, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 02.02.2022, pra brenda afatit ligjor 4-mujor të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

14. Për sa i përket legjitimitetit *ratione materiae*, për pretendimin e cenimit të parimit të prezumimit të pafajësisë, kërkuesi ka parashtruar si argumente se fajësia e tij nuk është provuar gjatë gjykimit në të gjitha shkallët dhe se gjykatat kanë gabuar, duke shkelur nenin 390 të KPP-së, pasi e kanë dënuar pa asnjë lloj prove dhe në kundërshtim të plotë me rrethanat e ngjarjes. Gjykatat nuk kanë pasur asnjë provë që ta implikojë atë në veprat e kryera nga grupi i strukturuar kriminal. Sipas tij, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe Gjykata e Lartë kanë gabuar në zbatimin e nenit 55 të KP-së, sepse i kanë dhënë dënim më të madh sesa shuma aritmetike e të gjitha dënimeve për secilën vepër. Ato i kanë rënduar artificialisht masën e dënimit, edhe pse pasojat nuk ishin të rënda. Ai ka pretenduar, gjithashtu, se Gjykata e Lartë i ka mohuar të drejtën e përfitimit nga ligji penal favorizues, si dhe ka shkelur nenin 48 të KP-së, pasi vendimi i shkallës së parë është dhënë në vitin 2016, përgjatë të cilit kërkuesi ka treguar respekt ndaj ligjit dhe ndaj bashkëvuajtësve, duke u zhveshur nga qenia “person me rrezikshmëri”.

15. Sipas parimit të prezumimit të pafajësisë, të garantuar në nenin 30 të Kushtetutës, kushdo quhet i pafajshëm, përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë dhe ai kërkon që deklarimi i fajësisë së të pandehurit të bëhet nga gjykata vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes, në përputhje me parimin e kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve në gjykim (*shih vendimin nr. 68, datë 14.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Për sa i takon faktit se gjykatat e kanë dënuar pa asnjë lloj prove dhe në kundërshtim të plotë me rrethanat e ngjarjes, Kolegji vëren se ky pretendim i kërkuesit ka marrë përgjigje si nga gjykatat e faktit, ashtu edhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (*shih paragrafin 43 të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*). Ky i fundit ka arsyetuar se fakti që i gjykuari personalisht nuk ka qenë i armatosur dhe nuk ka gjuajtur në drejtim të gardianëve, nga momenti që veprimet e të gjykuarit janë kryer në formën e grupit të strukturuar kriminal, nuk e përjashton atë nga përgjegjësia për veprat penale të kryera (*shih paragrafin nr. 47 të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

17. Nga sa më lart, përderisa Gjykata mund dhe duhet të investohet kur ndaj një procesi gjyqësor ka pretendime për mënyrat e marrjes së provave, por jo për mënyrën e vlerësimit (*shih vendimet nr. 23, datë 17.05.2010; nr. 45, datë 10.10.2010; nr. 37, datë 19.09.2011*), Kolegji vlerëson se pretendimet e kërkuesit për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë janë me

natyrë ligjore dhe kanë të bëjnë më çështje të vlerësimit të provave dhe zbatimit të ligjit, të cilat, si rregull, janë atribut i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe nuk mund të bëhen objekt i kontrollit kushtetues. Në këtë kuptim, duke qenë se kërkuesi nuk ka arritur të argumentojë se si vendimet gjyqësore të kundërshtuara kanë cenuar parimin kushtetues të prezumimit të pafajësisë, Kolegji çmon se ai nuk ka arritur ta ngrejë këtë pretendim në nivel kushtetues.

18. Për sa i përket pretendimit për cenimin e së drejtës së aksesit, të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar, në Gjykatën e Lartë, ai është një pretendim me natyrë kushtetuese që *prima facie* bën pjesë në juridiksionin kushtetues, ndaj do të analizohet në vijim.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit dhe së drejtës për t'u dëgjuar

19. Kërkuesi pretendon se Gjykata e Lartë ka rënduar pozitën e tij procedurale, duke e shqyrtuar çështjen në dhomën e këshillimit, pa i dhënë mundësinë për t'u dëgjuar në seancë, si dhe duke i shtuar masën e dënimit edhe me 8 vjet, në tejkalim të kompetencave të saj.

20. Lidhur me të drejtën e aksesit, Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. E drejta për të pasur akses në gjykatë i garanton individit të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj, të arsyetuar, për pretendimet e ngritura (*shih vendimin nr. 11, datë 21.04.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithashtu, në lidhje me gjykimin në Gjykatën e Lartë, Gjykata është shprehur se kjo e fundit ka detyrimin që jo vetëm të njoftojë rregullisht palët për procesin, por edhe t'u sigurojë atyre mundësinë që të marrin pjesë në proces dhe të dëgjojnë, qoftë edhe mbi bazën e dokumenteve. Gjykata e Lartë duhet t'u garantojë palëve të drejtën që jo vetëm të njihen në kohë me pretendimet e palës tjetër, por edhe të kenë mundësinë që t'i kundërshtojnë ato ose të paraqesin argumentet e tyre për çështjen (*shih vendimin nr.17, datë 01.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në lidhje me shqyrtimin e çështjes në Gjykatën e Lartë, në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se në rast se kolegji në dhomën e këshillimit krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs janë të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në ato që parashikon dispozita ligjore ose nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e rekursit. Veprimtaria seleksionuese e dhomës së këshillimit nuk është një shkelje e së drejtës së palëve për t'iu drejtuar gjykatës, por një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj. Ky lloj shqyrtimi paraprak vlerësues është kompetencë vetëm e trupit

gjykues të Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi dhe nuk mund të bëhet pjesë e kontrollit kushtetues që zhvillon Gjykata (*shih vendimet nr. 21, datë 20.03.2017; nr. 8, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Duke iu rikthyer rastit konkret, referuar rregullave të shqyrtimit të rekursit në Gjykatën e Lartë, sipas nenit 433 të KPP-së: “1. *Rekursi nuk pranohet në qoftë se bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që lejon ligji, si dhe kur Gjykata e Lartë çmon se çështja nuk duhet të shqyrtohet prej saj, sipas përcaktimeve të paragrafit 1, të nenit 432, të këtij Kodi.* 2. *Mospranimi i rekursit vendoset nga një trup gjykues me tre gjyqtarë në dhomën e këshillimit.*”. Kurse sipas nenit 436/a, pika 1, të KPP-së: “*Shqyrtimi i rekursit në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi.*”. Në lidhje me rregullat e njoftimit në atë gjykatë, sipas nenit 436, pika 3, të KPP-së: “*Sekretaria e gjykatës njofton palët nëpërmjet afishimit në këndin e njoftimeve dhe faqen elektronike zyrtare për datën dhe orën e gjyqimit të paktën 30 ditë përpara. Kur palët kanë adresa elektronike të deklaruara apo të njohura, sekretaria kryen njoftimin edhe në këto adresa.*”.

23. Kërkuesi rezulton se ka qenë një nga palët që ka vënë në lëvizje Gjykatën e Lartë, përveç Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, duke parashtruar në recurs shkaqet për cenimin e vendimeve të gjykatave më të ulëta. Gjykata e Lartë, pasi i ka marrë në shqyrtim ato, ka vlerësuar se “*shkaqet e ngritura në rekursin e paraqitur nga i gjykuari nuk janë të bazuara. Këto shkaqe nuk janë të tilla që të cenojnë vendimmarrjen e gjykatave të faktit lidhur me individualizimin dhe kualifikimin e veprave penale të kryera prej të gjykuarit. Rezulton se lidhur me këtë aspekt të vendimmarrjes, nuk ka mosrespektim ose zbatim të gabuar të ligjit penal nga gjykatat e faktit, nuk jemi përpara rastit kur këto gjykata kanë bërë shkelje që kanë si pasojë pavlefshmërinë absolute të vendimit, sipas nenit 128 të këtij Kodi, apo shkelje procedurale që kanë ndikuar në dhënien e vendimit në dëm të të gjykuarit që ka paraqitur recurs.*”.

24. Në lidhje me pretendimin se shqyrtimi i çështjes në dhomën e këshillimit i ka rënduar pozitën e tij procedurale dhe se Gjykata e Lartë ka shtuar masën e dënimit, Kolegji konstaton se në rastin konkret Kolegji Penal ka vepruar në përputhje me rregullat procedurale të zbatueshme për shqyrtimin e rekursit dhe vendimmarrjen. Kolegji Penal, duke lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, pasi vendimmarrjen e saj e ka vlerësuar si të marrë në zbatim të drejtë të ligjit, ka lënë në fuqi edhe masën e dënimit të caktuar për kërkuesin nga kjo gjykatë, duke mbajtur në konsideratë rrezikshmërinë e veprave penale dhe të autorit të saj dhe nuk ka vendosur vetë ndonjë masë të ndryshme dënimi për të. Për sa më sipër, ky pretendim i kërkuesit është haptazi i pabazuar.

25. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa e paraqitur nga kërkuuesi nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronjat “a” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.